



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0843

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “SRAHEP” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 20/12/2023, mori këtë:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e SRAHEP SH.P.K. me nr. 2023/0843, e datës 27/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së”, me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.
2. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit

31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.09.2023, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 600,000.00 €.

Me 23.10.2023, OE “SRAHEP” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 31.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “SRAHEP” SH.P.K me nr. 843/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SRAHEP” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se: “Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së, me nr. të prokurimit : 616-23-9889-1-1-1 dhe nr. të brendshëm: 616 23 180 111. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat favorizojnë ndonjë Operator Ekonomik pasi që nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë. Me datën 18.10.2023 kemi paraqitur kërkesën për sqarimin e tenderit në lidhje me specifikimet teknike të paraqitura në dosjen e tenderit për procedurën në fjalë në të cilën kemi kërkuar sqarim se në çfarë përqindje lejohet dallimi në dimensione tek inventari Medicinal, përkatësisht pozitat 25, 26, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, dhe 111. Pasi që duke e ditur që inventari medicinal nuk prodhohet në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk mund të bëhet “costum made” atëherë duhet të lejohet që dimensionet dhe specifikat të ndryshojnë së paku +/-10 % në mënyrë që të mundësohet sa më shumë pjesëmarrja e O.E. dhe prezantimi i brendeve të ndryshme. Përndryshe kjo qartazi paraqet shkelje dhe është në kundërshtim të plotë me Nenin 28 të LPP-se për specifikime teknike. Autoriteti Kontraktues në lidhje me kërkesën për sqarimin e tenderit të cekur më lartë nuk na ofron sqarimin edhe përkundër që kërkesën e kemi paraqitur brenda afatit të përcaktuar kohor për sqarimin e dosjes së tenderit dhe Autoriteti Kontraktues është i obliguar që sa më parë të ofroj sqarimet dhe ti njoftoj operatorët ekonomik. Kështu që mos ofrimi i informatave sqaruese për Operatorët Ekonomik, kur kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor paraqet shkelje të dispozitave të nenit 24 të Rregullores së Prokurimit 001/2022. Autoriteti Kontraktues ka hequr nga platforma elektronike dosjen e tenderit dhe në vend të sajë ka vendosur përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet saktë se cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tender pasi që ka bërë korrigjim të dosjes së tenderit por ndryshimet nuk i ka paraqitur në dosjen e re të tenderit. Mos vendosja e dosjes së tenderit në platformën elektronike paraqet shkelje të nenit 17 të Rregullores së Prokurimit 001/2022 konkretisht paragrafët 17.12 dhe 17.16 Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kapaciteti teknik dhe profesional në pikën nr. 6 ka paraqitur kërkesën: 6. Autorizimi i prodhuesit apo dilerit dhe Katalogu Broshura origjinale e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111. Kërkesa që për pozicione e lartcekura te paraqitet autorizimi i prodhuesit apo dilerit të autorizuar e kufizon shkajshmërisht konkurrencën pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Gjithashtu nga AK janë paraqitur specifikat teknike të përshtatura pike përprike për një prodhues. Kjo është në kundërshtim me Neni 28 të LPP-s – Specifikimet teknike – pasi që për arsye të përshtatjes pikë për pikë te specifikimeve teknike te produkteve te prodhuesit “Turmed” për pozicionet.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 nuk është lënë mundësia që

të konkurrohet me produkte nga prodhuese tjerë. Andaj me këtë specifikim teknik është ngushtuar pjesëmarrja e Operatoreve Ekonomik të tjerë gjegjësisht edhe prodhuesve të tjerë me renome botërore. https://www.turmedonline.com/UploadFile/Katalog/turmed-catalog_GsMpR.pdf ----- linku i katalogut Turmed. Nga katalogu i lartcekur vërehet qartë që specifikat teknike i janë përshtatur plotësisht prodhuesit Turmed. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-se pasi që diskriminohen prodhuesit tjerë si dhe ofertuesit të cilët planifikojnë që të marrin pjesë në këtë tender. Prandaj, kërkesa që O.E. të paraqesin Autorizimin e prodhuesit dhe Katalogu Broshura origjinale e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 duhet të hiqet pasi që sikur kemi cekur kjo kërkesë e favorizon vetëm prodhuesin Turmed dhe diskriminon prodhuesit apo O.E. tjerë. Autorizimi është kërkesë e cila është në kundërshtim edhe me nenin 69 të LPP-s pasi që nëasnjërin nga dispozitat e këtij neni nuk është dhënë mundësia për të kërkuar autorizimin e prodhuesit për produkte të caktuara. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues tek kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale neni 9.1 & 9.2 në pikën nr. 3 ka paraparë kërkesën që O.E të jetë i certifikuar me certifikaten ISO 13485 2016 e cila nuk është relevant me natyrën e projektit por kjo kërkesë shihet qartas që është kërkuar me qëllim të favorizimit të ndonjë O.E. andaj AK ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s. Pasi kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues ka pezulluar procedurën e prokurimit por nuk na ka kthyer kurrfarë përgjigje në lidhje me kërkesën tonë. Në nenin 61. paragrafi 6.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik është paraparë që Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Ne nuk kemi marrë kurrfarë njoftimi për zgjatje të afatit edhe përkundër se ka kalua afati tre (3) ditor.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “SRAHEP” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 28, 51 dhe 69 të LPP dhe shkeljet e nenit 4, 17, 24 dhe 25 të RRUOPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht të pezullon aktivitetin e prokurimit në fjalë deri sa të shqyrtohet ankesa jonë dhe të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të mënjanon kriteret diskriminuese teknike dhe ato të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 843/23, ndërsa me datë 13/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0843 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit duke lejuar një

tolerance +/-5% te dimensioneve dhe peshave te inventarit me përjashtim te pajisjeve qe domosdoshmerisht për arsye objektive duhet te kenë dimensionet dhe peshën ashtu si është kërkuar, dhe të zgjasë afatin për ofertim. ”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është deklaruar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues/teknik ndërsa OE nuk është pajtuar me rekomandimet e të ekspertit shqyrtues/teknik duke theksuar se “ *eksperti shqyrtues ka zgjedhur për trajtim vetëm disa pretendime tona ankimore, pra nuk I ka trajtuar të gjitha pretendimet. Autoriteti Kontraktues ka hequr nga platforma elektronike dosjen e tenderit dhe në vend të sajë ka vendosur përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet sekt se cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tender pasi që ka bërë korrigjim të dosjes së tenderit por ndryshimet nuk i ka paraqitur në dosjen e re të tenderit, kështu qe ka lënë mundësin e manipulimit me kërkesat për pjesëmarrje. Mos vendosja e dosjes së tenderit në platformën elektronike paraqet shkelje të nenit 17 të Rregullores së Prokurimit 001/2022 konkretisht paragrafët 17.12 dhe 17.16. Eksperti Shqyrtues fare nuk e ka trajtuar këtë pretendim. Gjithashtu ne Me datën 18.10.2023 kemi paraqitur kërkesën për sqarimin e tenderit në lidhje me specifikimet teknike të paraqitura në dosjen e tenderit për procedurën në fjalë në të cilën kemi kërkuar sqarim se në çfarë përqindje lejohet dallimi në dimensione tek inventari Medicinal, përkatësisht pozitat 25, 26, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, dhe 111. Pasi që duke e ditur që inventari medicinal nuk prodhohet në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk mund të bëhet “costum made” atëherë duhet të lejohet që dimensionet dhe specifikat të ndryshojnë së paku /-10 % në mënyrë që të mundësohet sa më shumë pjesëmarrja e O.E. dhe prezantimi i brendeve të ndryshme. Përndryshe kjo qartazi paraqet shkelje dhe është në kundërshtim të plotë me Nenin 28 të LPP-se për specifikime teknike. Autoriteti Kontraktues nuk na ofron fare sqarim në lidhje me kërkesën tonë edhe përkundër që kërkesën e kemi paraqitur brenda afatit të lejuar për sqarimin e tenderit. Eksperti shqyrtues fare nuk e ka trajtuar shkeljen e dispozitave të nenit 24 të Rregullores së Prokurimit 001/2022. Sa i përket pretendimit të përshtatjes së specifikave të cilat Autoriteti Kontraktues i ka marrë drejtpërdrejtë nga katalogu i firmës “TURMED” eksperti shqyrtues ka konstatuar që OE ankues ka ofruar katalogun e prodhuesit TURMED duke pretenduar se pozicionet: 23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 jane me specifikacione teknik te përshtatur për këtë prodhues, por OE ankues nuk ka dëshmuar me fakte ose prove se ku gjinden keto pozicione ne katalog te ketij prodhuesi, dhe nuk ka bere vërtetim te ketij pretendimi ankimore andaj vleresohet pjeserisht e bazuar. Ne kemi paraqitur linkun në ankesën tonë i cili mund të kopjohet dhe të kërkohet në google me ç’rast paraqitet katalogu si dhe duke i shiquar specifikat teknike të pozicioneve të lartcekura tek përshkrimi i çmimit mund të krahasohen specifikat të cilat janë tërësisht të njëjta me katalogun e prodhuesit TURMED ku Madekos ka autorizimin nga ky prodhues, andaj eksperti shqyrtues nuk e ka marrë për bazë këtë fakt. Shih linkun: https://www.turmedonline.com/UploadFile/Katalog/turmed-catalog_GsMpR.pdf. Me tej eksperti shqyrtues konstaton se Kriteri për Autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi, është i domosdoshëm për produkte vitale te AK, sepse e siguron qe janë konform kërkesave teknike. Por me këtë rast nuk e merr për bazë se ky kriter e*

rrit koston e çmimit si dhe nuk është aspak e vërtetë që vetëm produktet me autorizim të nga prodhuesi apo dileri i autorizuar siguron që janë konforme kërkesave teknike, pasi që në tregun e Kosovës ka mjaftueshëm produkte të cilat i plotësojnë specifikat e kërkuara por me një ndryshim prej +/- 10%. Gjithashtu edhe sa i përket pretendimit tonë për Katallogun ekspertit shqyrtues cek se katalogu ose foto me përshkrim teknik nga prodhuesit, ofrojne shumëllojshmeri të tipeve për një produkt dhe nuk duhet të konsiderohet kriter diskriminues. Ndërsa në qartë kemi cekur se autoriteti ka paraqitur kërkesën diskriminuese Autorizimi i prodhuesit apo dilerit dhe Katallogu Broshura origjinale e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111. Pra sikur shihet nga kërkesa e AK-s është kërkuar që të paraqitet Katallogu Broshura origjinale e prodhuesit dhe jo katalogu ose foto me përshkrim teknik sikur ka cekur ekspertit shqyrtues. Gjithashtu sa i përket certifikatës ISO 13485 2016 ekspertit shqyrtues konstaton se është një standard ndërkombëtar që përshkruan kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë në industrinë e pajisjeve mjekësore, por nuk e merr për bazë se shumica e artikujve janë inventar për zyre. Por ne kemi vërtetuar që kjo kërkesë e cila nuk është relevante me natyrën e projektit shihet qartas që i është përshtatur operatrëve ekonomik Madekos dhe Wood Corporation L.L.C. të cilët janë marrë vesh me Autoritetin Kontraktues dhe të cilët që nga paraqitja e ankesës janë munduar që në formë të ndryshme të na shantazhojnë përmes dhjetra personave ndër të cilët edhe zyrtar, duke kërkuar nga ne që ta tërheqim ankesën, por ne nuk kemi marrë parasysh kërkesat e tyre dhe jemi të gatshëm që ti paraqesim tek organet përkatëse të drejtësisë. Gjithashtu ekspertit shqyrtues fare nuk e ka shqyrtuar pretendimin tonë për shkelje të dispozitave të nenit 61. paragrafi 6.3 të Rregullores 001/2022 nga AK duke mos e shqyrtuar fare kërkesën tonë për rishqyrtim. Pra kërkesat të cilat ne kemi kërkuar nga AK dhe OSHP që ti heqin, janë kërkesa në kundërshtim me nenin 7 të LPP-s si dhe me dispozitat tjera të legjislacionit të prokurimit të cilat i janë përshtatur operatorëve ekonomik të lartcekur, ndërsa i diskriminojnë kompanit e reja që të marrin pjesë në tenderët e natyrës së njejtë. Prandaj kërkojmë nga OSHP që të aprovohet ankesa jonë si tërësihtë e bazuar dhe të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të mënjanon kriteret diskriminuese teknike dhe ato të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "SRAHEP" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0843 ka vlerësuar si në vijim:

Ekspertja teknike konstaton se në FDT të Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, AK ka deklaruar se SPECIFIKIMET TEKNIKE MUND TË SHKARKOHEN PERMES E-PROKURIMIT, por vetëm të Paramasa dhe Parallogaria kam gjetur përshkrimin e produkteve. Në disa pozicione është cituar "Furnizimi, blerja dhe montimi ...", duke bërë të paqart kërkesën për pozicionin me fjalet Furnizim dhe Blerje !? Autorizimi nga prodhuesi apo dileri është kriter që vendoset nga AK për të deshmuar konformitetin e produktit nga vet Prodhuesi apo Dileri se janë plotësuar kërkesat teknike të përcaktuara me dispozita që zbatohen për një produkt të caktuar.

Ekspertja teknike konstaton se ka OE ankues ka ofruar katallogun e prodhuesit TURMED duke pretenduar se pozicionet: 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111 janë me specifikacione teknik të përshtratur për këto prodhues, por OE ankues nuk ka deshmuar me fakte ose prove se ku gjenden këto pozicione në katallog të këtij prodhuesi, dhe nuk ka bërë vërtetim të këtij pretendimi ankimore andaj vlerësohet pjesërisht e bazuar.

Kriteri për Autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi, është i domosdoshëm për produkte vitale të AK, sepse e siguron që janë konforme kërkesave teknike.

Katallogu ose foto me përshkrim teknik nga prodhuesit, ofrojnë shumë-llojshmeri të tipeve për një produkt dhe nuk duhet të konsiderohet kriter diskriminues.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përshkruan kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë në industrinë e pajisjeve mjekësore. Ky standard është specifik për pajisjet mjekësore dhe mbulon të gjithë ciklin e jetës së një pajisjeje, nga projektimi dhe zhvillimi deri të prodhimi, instalimi dhe servisimi. Ai synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar, andaj është e drejtë e AK ta vendosë në kriter.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues dhe teknik i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "SRAHEP" SH.P.K. Argumentimi në raportin e eksperteve është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të eksperteve. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "SRAHEP" SH.P.K janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të obliguar AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytimit të dhëna nga ana e eksperteve në raportin e përgatitur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së" me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1. Pra, Paneli Shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit duke lejuar një tolerance të dimensioneve dhe peshave të inventarit, me përjashtim të pajisjeve që domosdoshmerisht për arsye objektive duhet të kenë dimensionet dhe peshën ashtu si është kërkuar.

Lidhur me pohimin e ankuesit se AK ja ka përshtat specifikimet teknike vetëm të një prodhuesi atëherë paneli shqyrtues mendon se kjo paraqet shkelje të nenit 28 të LPP, kështu që AK është i obliguar që hartimin e Dosjes së Tenderit ta bëjë konform nenit 27 dhe 28 të LPP. Kështu që, AK duhet të ndërmarrë masa të verifikoj këto konstatime të OE ankues dhe nëse këto janë të qëndrueshme atëherë ti bëjë këto përmirësime. Deri në përfundim të këtij vlerësimi paneli shqyrtues erdhi si pasojë e mos konstatimit të saktë të gjendjes nga ana e ekspertëve shqyrtues.

Lidhur me pohimin e ankuesit sa i përket autorizimit nga prodhuesi apo dileri, paneli shqyrtues nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sepse kanë dallim autorizimet dhe deklaratat e konformitetit, gjë që nuk janë të njëjta, andaj, për panelin shqyrtues një kriter i tillë lidhur me këtë natyrë të furnizimit është kriteri i rëndësishëm dhe kufizon në masë të madhe konkurrencën. Po ashtu, paneli shqyrtues nuk pajtohet edhe në këtë rast me ekspertin shqyrtues sepse deri te ky konstatim eksperti shqyrtues ka ardhur si rezultat se kjo certifikatë "synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar", ndërsa, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me inventar duke përfshirë në specifikacion, perde, ormana, karrika, etj. Kështu që AK duhet të veprohet konform nenit 51, paragrafi 1 i LPP, citat: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk

duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji".

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se ankesa është e bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK lidhur me atë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SRAHEP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: